



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR MATURËN SHTETËRORE**

(Provim me zgjedhje për shkollat e mesme artistike dega “Muzikë”)

LËNDA:

HISTORI MUZIKE

Koordinatori: Majlinda Hala

Viti shkollor: 2014 -2015

**TIRANË
JANAR, 2015**

1. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Histori muzike”, përfshin njohuritë, konceptet dhe aftësitë më të rëndësishme të historisë së muzikës për shkollën e mesme artistike të sistemit 3- dhe 4-vjeçar.

Programi orientues për provimin me zgjedhje “Histori muzike”, mbështetet në udhëzimin Nr. 1, datë 12.01.2015 të MAS-it për “Zhvillimin e Provimeve të Maturës Shtetërore 2015”, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme artistike, dega “Muzikë”, për nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi:

- Gjeron informacionin e nevojshëm për mësuesit e historisë së muzikës të shkollave artistike, që do të përgatisin maturantët për provimin e historisë së muzikës, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Orienton nxënësit për materialet kyçe mësimore, *njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore* që duhet të zotërojnë nxënësit për të përballuar me sukses provimin e historisë së muzikës, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Përbën, gjithashtu, një *dokument zyrtar* që duhet zbatuar me korrektësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë së muzikës, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Programi orientues i historisë së muzikës synon vlerësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë lëndë.

Ky program orientues është strukturuar në bazë të disa rubrikave që janë:

1. Tematikat, që përshkruajnë përmbajtjen e programit.
2. Përshkrimi i tematikës dhe objektivat.
3. Tabela e peshave.

Programi duhet shqyrtuar me kujdes dhe korrektësi nga secili prej grupeve të interesuara. Kujdes i veçantë të bëhet nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë së muzikës, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program.

Vëmendje të tregojnë këta specialistë dhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila temë studimi në këtë program, me përqindjet që zënë këto tema në testin e provimit.

Përgatitja e nxënësve për provimin e historisë së muzikës, të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve muzikore dhe aftësive të përcaktuara në program. Për të arritur këtë, ata duhet t'u rikthehen dhe çështjeve të ndryshme, të cilat nuk janë parashikuar në program, por që përmbajnë informacion bazë për të përvetësuar materialin e zgjedhur për provim. Materiali burimor mbi të cilin duhet të punojnë nxënësit janë leksionet që ata kanë marrë nga mësuesit e tyre apo të gjitha burimet që kanë përdorur gjatë viteve për shqyrtimin e përbajtjeve mësimore, të tillë si: leksione, tekste të ndryshme që kanë të bëjnë me historinë e muzikës, interneti etj.

2. TEMATIKAT E PËRMBAJTJES SË PROGRAMIT

- 1. Zhvillimi i muzikës në Mesjetë**
- 2. Rilindja Europeiane dhe muzika**
- 3. Baroku dhe muzika instrumentale**
- 4. Kultura muzikore në Klasizizëm**
- 5. Kultura muzikore në Romantizëm**

6. Muzika në shekullin XX

7. Muzika shqiptare

3. TEMATIKA

1. Zhvillimi i muzikës në Mesjetë

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e muzikës dhe përfaqësuesit kryesorë në periudhën e Mesjetës. Përmes njohjes së zhvillimit të artit muzikor në këtë periudhë, nxënësit mësojnë ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore përgjatë kësaj periudhe; analizojnë muzikën kishtare, koralin gregorian, polifoninë vokale, madrigalin, kaçian, shkrimin muzikor, psalmet dhe kuptojnë ndikimin e traditës së muzikës kishtare në artin e Mesjetës. Gjithashtu, një vend të veçantë zë edhe njohja me përfaqësuesit kryesorë të kësaj periudhe.

Nr	Tematika	Objektivat
1.	Kultura muzikore në Mesjetë	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njojin zhvillimin e kulturës muzikore në Mesjetë. - shpjegojnë ç'përfaqëson korali gregorian dhe çfarë veçorish e karakterizojnë atë. - përshkruajnë faktorët që mundësuan lulëzimin e muzikës laike në Mesjetë. - përcaktojnë tiparet e muzikës polifonike mesjetare. - analizojnë faktorët që çuan në lindjen e shkrimit muzikor. - njojin përfaqësuesit e muzikës së kësaj periudhe.

2. Rilindja Europiane dhe muzika

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e muzikës në periudhën e Rilindjes. Ajo njeh nxënësit me zhvillimin e artit muzikor, duke shpjeguar ndikimet dhe karakteristikat e tij historike, shoqërore dhe kulturore përgjatë kësaj periudhe. Përmes tij, nxënësit studiojnë: *muzikën vokale shkollat polifonike*, *muzikën instrumentale*, *qendrat kryesore të zhvillimit të muzikës*, si dhe *përfaqësuesit kryesore të zhvillimit të artit muzikor*.

Nr	Tematika	Objektivat
2.	Kultura muzikore në Rilindje	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">- njihen me zhvillimin e muzikës në periudhën e Rilindjes.- shpjegojnë zhvillimin e polifonisë dhe të formave të reja muzikore vokale laike.- përshkruajnë veçoritë e gjinive kryesore të muzikës vokale: madrigali, oratorio, psalmet etj.- studiojnë muzikën e shkollave polifonike dhe përfaqësuesit e tyre.- përcaktojnë instrumentet muzikore më të përdorura gjatë periudhës së Rilindjes.- njojin përfaqësuesit dhe të analizojnë veprat kryesore muzikore të kompozitorëve të Rilindjes.

3. Baroku dhe muzika instrumentale

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë do të ndihmojë nxënësit të njohin zhvillimin e muzikës në periudhën barok. Ajo aftëson nxënësit të shpjegojnë zhvillimin e muzikës në këtë periudhë, duke përcaktuar ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore. Përmes saj, nxënësit njihen me *lindjen dhe zhvillimin e operës në shek. XVIII*, me *zhvillimin e muzikës instrumentale të shek. XVII-XVIII* dhe *lindjen e gjinive të reja muzikore*, *zhvillimin e muzikës për ansambël instrumental dhe për violinë solo*, me *zhvillimin e mëtejshëm të muzikës vokale: kantata dhe oratori*, si dhe përfaqësuesit kryesorë të kësaj periudhe, si : J.S. Bach dhe Zh. F. Hendel, Vivaldi etj.

Nr	Tematika	Objektivat
3.	Kultura muzikore në Barok	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - rendisin disa tipare shoqërore -historike të kësaj periudhe. - njihen me lindjen e operës së shek. XVIII. - përshkruajnë zhvillimin e operës në Europë gjatë shek. XVIII. - njihen me zhvillimin e muzikës barok dhe muzikës instrumentale. - shpjegojnë elementet muzikore të stilit barok në instrumentet me tastierë dhe instrumentet me harqe. - përshkruajnë lindjen e muzikës për ansambël instrumental dhe për violinë solo. - klasifikojnë në vepra dhe autorë llojet e stilit barok (monodi, homofoni, polifoni). - përcaktojnë disa nga gjinitë kryesore muzikore të kësaj periudhe. - njohin përfaqësuesit kryesorë dhe të analizojnë veprat kryesore muzikore të kompozitorëve të periudhës barok.

4. Romantizmi muzikor

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e muzikës në periudhën e Klasicizmit. Ajo njeh nxënësit me zhvillimin e muzikës, duke shpjeguar ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore përgjatë kësaj periudhe. Në këtë periudhë, arti muzikor fitoi tipare të reja, duke u ndarë nga stili strikt dhe i ngarkuar me tinguj zbulurues.

Përfaqësuesit më të shquar të Klasicizmit, që mbajtën gjithë peshën e ndryshimeve e të zhvillimeve progresiste të epokës së tyre, si dhe kompozitorët e mëdhenj të shkollës vjeneze janë: F. J. Hajden, V. A. Moxart, L. V. Beethoven. Reformat në opera me përfaqësuesin e saj K. V. Gluk.

Përmes kësaj tematike, nxënësit njihen me *krijimin e simfonisë dhe sonatës klasike, me forma muzikore të përcaktuara qartë, me melodi klasike të thjeshta, të qarta dhe të këndueshme, me stilin polifonik e harmonik, me një stil të ri në instrumentet me tastierë,, si dhe me reformimin e operës lirike europiane.*

Nr	Tematika	Objektivat
4.	Kultura muzikore në Klasicizëm	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">- rendisin disa tipare shoqërore -historike të kësaj periudhe.- njojin disa nga rregullat e stilit muzikor klasik.- dallojnë stilin e muzikës klasike nga stilet e tjera muzikore.- përcaktojnë llojet dhe gjinitë e muzikës klasike.- njojin zhvillimin e mëtejshëm të muzikës instrumentale, simfonike dhe vokale.- njojin përfaqësuesit dhe të analizojnë veprat kryesore muzikore të kompozitorëve klasikë.

5. Kultura muzikore në Romantizëm

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e muzikës në periudhën Romantike. Ajo njeh nxënësit me zhvillimin e muzikës, tiparet kryesore të muzikës së kësaj periudhe, duke shpjeguar ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore. Përmes studimit, nxënësit analizojnë veprat muzikore të përfaqësuesve kryesorë të kësaj periudhe.

Përmes kësaj tematike nxënësit do të njihen me *tiparet kryesore të zhvillimit të romantizmit, me zhvillimin muzikor në planin teknik dhe estetik, me krijimin e shkollave kombëtare, me krijimin e muzikës me program, me lindjen e formave të reja muzikore etj.*

Nr	Tematika	Objektivat
5.	Kultura muzikore në Romantizëm	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallojnë disa nga tiparet shoqërore -historike të kësaj periudhe. - njojin zhvillimin e mëtejshëm të muzikës instrumentale, simfonike, vokale dhe të muzikës me program. - njojin disa nga rregullat e stilit muzikor romantik. - dallojnë stilin e muzikës romantike nga stilet para klasike dhe klasike. - përcaktojnë llojet dhe gjinitë e muzikës romantike, si: <i>instrumentale, vokale, muzika e dhomës, simfonike, vokalo - simfonike dhe muzikës simfonike me program.</i> - njojin përfaqësuesit dhe të analizojnë veprat kryesore muzikore të kompozitorëve romantikë.

6. Muzika në shekullin XX

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e muzikës në periudhën e shekullit XIX - XX. Ajo njeh nxënësit me zhvillimin e muzikës në këtë periudhë, duke shpjeguar ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore përgjatë kësaj periudhe. Përmes saj, nxënësit jo vetëm që mësojnë për zhvillimin kronologjik të historisë së muzikës, por njihen dhe me kushtet historike, sociale dhe artistike, si dhe me përfaqësuesit kryesorë të kësaj periudhe. Përmes kësaj tematike, nxënësit njihen me *krijimin modern, me thyerje të formave tradicionale dhe rregullave të kompozimit, me muzikën atonale, me bashkëjetesë të disa stileve muzikore* (, verizëm, impresionizëm, ekspresionizëm, neoklasicizëm), *me shtrirje gjeografike globale, me lloje muzikore dhe bashkëveprimi ndërmjet tyre i xaz-it dhe muzikës pop, me muzikën dhe teknologjinë e saj.*

Nr	Tematika	Objektivat
6.	Kultura muzikore në shek. XX	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallojnë tiparet shoqërore - historike të kësaj periudhe. - njohin zhvillimin e mëtejshëm të muzikës instrumentale, vokale, simfonike, dhe të muzikës me program. - përcaktojnë stilet muzikore të periudhës. - dallojnë elementet teknikë, si: <i>harmonia, meloritmika, orkestracioni</i>. - njohin llojet muzikore të shek. XIX - XX dhe bashkëveprimin midis tyre, të xaz-it dhe të pop-it dhe rrymave të tjera. - përshkruajnë zhvillimin teknologjik në muzikë. - njohin përfaqësuesit dhe veprat kryesore muzikore të kompozitorëve të shek. XX.

7. Muzika shqiptare

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e muzikës shqiptare. Ajo njeh nxënësit me zhvillimin e muzikës shqiptare, duke shpjeguar ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore përgjatë kësaj periudhe. Përmes saj, nxënësit mësojnë jo vetëm për zhvillimin e historisë së muzikës shqiptare, por njihen dhe me veprat dhe përfaqësuesit kryesorë të muzikës shqiptare. Përmes kësaj tematike, nxënësit njihen me *zhvillimin e muzikës shqiptare në periudha të ndryshme, me zhvillimin e muzikës vokale shqiptare, me lindjen dhe zhvillimin e operës shqiptare, me muzikën instrumentale, me muzikën simfonike, me muzikën e dhomës etj.*

Nr	Tematika	Objektivat
7.	Kultura shqiptare	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">- përcaktojnë periudhat e zhvillimit të muzikës shqiptare.- dallojnë tiparet kombëtare të muzikës shqiptare.- njohin zhvillimin e muzikës <i>instrumentale, simfonike, vokale dhe të muzikës simfonike.</i>- njohin disa nga rregullat muzikore të stilit muzikor shqiptar.- përcaktojnë llojet dhe gjinitë e muzikës shqiptare: <i>vokalo - instrumentale, muzikës së dhomës, simfonike, vokale simfonike dhe muzikës simfonike: rapsodia, vallja simfonike, uvertura etj.</i>- njohin veprat kryesore muzikore të kompozitorëve shqiptarë.

4. TABELA E PESHËS SË TEMATIKAVE NË PËRQINDJE

Tematika	Përqindja
Muzika në Mesjetë	5 %
Muzika në Rilindje	8 %
Muzika Barok	10 %
Muzika në Klasicizëm	25 %
Muzika në Romantizëm	37 %
Muzika në shekullin XX	10 %
Muzika shqiptare	5 %
Gjithsej:	100%